

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Jahelezi-Construction sh.p.k**

Ne Kavaje, sot me date 12 Tetor 2023 , u paraqit personalisht ortaku themelues:

Enio JAHELEZI, i biri i Ferizit , datelindja 25/03/1980 , lindur ne _Tropoje , me zotesi te plete juridike per te vepruar, identifikuar me Nr.personal Leternjoftim 032979861,banues në Rruga "Bedri Karapici" Godina nr 15 ish qyteti nxenesve Tirane.

Deklaroj me vullnetin tim te plete e te singert dhe me inisiativen time te lire dhe private mbështetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodin civil ne fuqi,ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertim

Jahelezi-Construction sh.p.k

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte **Jahelezi-Construction sh.p.k**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **Jahelezi-Construction sh.p.k** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i shoqerise, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulone personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjeshëm me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Selia e Shoqerise eshte Rruga IRFAN TOMINI ,zona kadastrale 8260,nr pasurise 2/241-N8 Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut të Shoqërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e me poshtem(vetem nese eshte i përcaktuar)

1 

Ndertim objektesh te ndryshme, rikonstruksione ne te gjitha fushat e ndertimit ,punime elektrike dhe hidraulike etj. Ndertime civile ekonomike dhe industriale, rikonstruksione godinash, veshje fasade etj. Import-eksport i te gjithe llojeve te materialeve dhe makinerive të ndërtimit. Ndertim, permiresim, mirembajtje te rrugeve, autostradave, mbikalimeve dhe nenkalimeve, urave,tuneleve, digave, hidrocentraleve dhe veprave te tjera te infrastrukture, si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjeter te nevojshem, ndihmes apo plotesues ne funksion te objektit kryesor te shoqerise. Ndertim vepra arti te vogla deri ne 10 metra, ujesjellesa kanalizime etj. Prodhim dhe tregetim materiale ndertimi. Projektim, konsulencë, sipas rastit. Punime dheu, sistemime terracime terrenesh, vepra kullimi e vaditese etj. Ndertim rruge, veshje rrugesh me asfaltobeton, ndertim mbishtrese etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te perspektuar te /shoqerise ose zgjatja e afatit, duhet te behet me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë (njeqind mijë leke). Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributit e tij .

Personi zoteron 100% te kapitalit ne shoqeri si ortak i vetem.

Kapitali eshte i korespondon nje 1 kuote te vetme me vlore 100.000 leke (njeqintemije leke) .

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqerie me përgjegjësi te kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter te parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit te kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten si dhe kushtet e tjera te kalimit ,perfshire momentin e pageses se çmimit ,rregullohen nga kontrata .Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakort ne kontrate,vlefshmeria kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do



te kushtezohet nga kryerja e formaliteteteve te ndryshme me efekt deklarativ ,perfshi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit".

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organ i Vendimmarres

Ortaku i vetëm eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i vetëm eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj. Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës per ceshtje te tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve,

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,

f) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:

Administratori i shoqërisë do të jetë Enio Jahelezi, lindur më 25/03/1980, në Tropoje, identifikuar me nr. Letërnjoftimi me nr. 032979861,

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;

c) kujdeset përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejne detyra të tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane një vlerë me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, që rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkarisht shoqerine.

Asambleja e per gjithshme, mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe, me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te maredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje te pote me kete akt themelimin statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


Ortaku i vetem i shoqerise si themelues i saj pasi e lexoi me vemendje akt themelimin e mesiperme



dhe duke qene konform vullnetit te tij e firmosi pa verejtje.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE
Jahlezi-Construction sh.p.k

Enio JAHELEZI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Enio Jahlezi". Above the signature, the name "Enio JAHELEZI" is printed in a smaller, bold, black font.